

BASHKIA KORÇE

NR 0507 PROT
DATA 17/09/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE
DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

Nr. _____ Prot.

Datë ____/____/2025

RELACION

“PËR TRAJTIMIN, E Z. FETI OSMANLLARI ME APARTAMENT NGA FONDI I BANESAVE ME KOSTO TË ULËT QË DO TË NDËRTOHET NË LAGJEN 10 RRUGA “THEODHOR KAVALIOTI” MBI PASURINË 1/860 ZK 8561, SIPAS MARRËVESHJES NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”


Bazuar në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak Nr. 105 dt. 25.07.2024 është nënshkruar marrëveshja e Bashkëpunimit « Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Korçë »,ku objekt i kësaj marrëveshje është financimi nga EKB i një objekti banimi me 8 kate dhe një kat parkimi nëntokë. Objekti i banimit do të ndërtohet në Lagjen 10 Rruga « Theodor Kavalioti » Korçë.

Gjithashtu midis Bashkisë Korçë dhe Entit Kombëtar të Banesave është nënshkruar kontrata e dhurimit të pasurisë të paluajtshme nr. 1096 rep nr. 823 prot dt 10.03.2025, ku Bashkia Korçë me cilësinë e dhuruesit, i dhuron Entit Kombëtar të Banesave pasurinë e llojit truall të ndodhur në ZK 8561 me nr. Pasurie 1/860, vol. 46, faqe 195, me adresë Rruga « Theodor Kavalioti » Korçë me sipërfaqe 1700 m2 truall, 239.2 m2 ndërtesë. Në këtë ndërtesë ka banuar zoti Feti Osmanllari e cila sot është prishur me vendimmarrje të IMT si ndërtim i palegalizuar dhe z. Feti Osmanllari mbetet i pastrehë.

Aktualisht bazuar në vendimmarjen e Këshillit Bashkiak nr 57 dt 26.06.2025 z Feti Osmanllari është përfitues nga programi i Subvencionimit të Qirasë.

Ndodhur në këto kushte bazuar në nenin 9 pika 1.1/1.2 dhe nenin 24 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, Ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM 384 dt. 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore” etj propozojmë që në përfundim të objektit 8 katësh, që do të ndërtohet mbi pasurinë 1/860, vol. 46, faqe 195, në Lagjen 10, Rruga « Theodor Kavalioti », z Feti Osmanllari të trajtohet me apartament nga fondi i banesave me kosto të ulët, vetëm nëse ai plotëson kriteret e legjislacionit në fuqi, në momentin e trajtimit me strehim.

Drejtoreshë e Përgjithshme Juridike
ANXHELA QERAMIXHI (DISHNICA)



Drejtoreshë e Strehimit Social
MIRELA BALLI



KRYETARI
SOTIRAQ FILO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë _____, 2025

“PËR TRAJTIMIN, E Z. FETI OSMANLLARI ME APARTAMENT NGA FONDI I BANESAVE ME KOSTO TË ULËT QË DO TË NDËRTOHET NË LAGJEN 10 RRUGA “THEODHOR KAVALIOTTI” MBI PASURINË 1/860 ZK 8561, SIPAS MARRËVESHJES NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot ,pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ekzekutivi si dhe bazuar në nenin 9 pika 1.1., 1.2, 24 dhe 54 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM 384 dt. 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore” etj

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI

- 1.Të trajtojë z Feti Osmanllari me apartament, nga fondi i banesave me kosto të ulët, që do të ndërtohet në Lagjen 10, rruga “Theodhor Kavaliotti”, mbi pasurinë 1/860 zk 8561, sipas marrëveshjes nënshkruar midis Bashkisë korçë dhe Entit Kombëtar të Banesave”, referuar normave të strehimit në fuqi,
2. Trajtimi sipas pikës 1 do të bëhet vetëm nëse ai plotëson kriteret e legjislacionit në fuqi, në momentin e trajtimit me strehim.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R E
ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____